



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr.426/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenkovic - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i operatoreve ekonomik: “N.T.SH “MARASH-SHPED” SH.P.K.- Gjakovë & “COMPANY ZUKA COMERCE” SH.P.K. – Gjakovë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE: N.N.SH “Korben” - Gjakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve”, me nr. prokurimit: 632-20-1237-5-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Gjakovë më datë: 27.07.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e grupit të operatorëve ekonomik: “N.T.SH “MARASH -SHPED” SH.P.K. - Gjakovë & “COMPANY ZUKA COMERCE” SH.P.K. - Gjakovë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve”, me nr.prokurimit: 632-20-1237-5-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Gjakovë.

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve”, me nr.prokurimit: 632-20-1237-5-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Gjakovë, dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e grupit të operatoreve ekonomik ankues: “N.T.SH “MARASH-SHPED” SH.P.K.- Gjakovë & “COMPANY ZUKA COMERCE” SH.P.K. - Gjakovë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Grupi i operatorëve ekonomik ankues N.T.SH “MARASH-SHPED” SH.P.K. - Gjakovë & “COMPANY ZUKA COMERCE” SH.P.K. - Gjakovë si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP me dt: 26.06.2020, me nr. 426/20, kundër njoftimit për dhënien e kontratës me titull: “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve”, me nr. prokurimit: 632-20-1237-5-2-1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/, Kuvendi Komunal Gjakovë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin : 6, 7, 56, 59, 60 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.07.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 13.07.2020 sqaron si në vijim:

Përgjigje në Pretendimin 1, Lidhur me pretendimin e grupit të OE N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk, se AK gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk kemi prezantuar CV-të dhe kontratat e punës për inxhinierin e ndërtimtarisë-drejtimit konstruktiv dhe për gjeodetin, që sipas OE ankues AK ka bërë shkelje të nenit 6,7,56,59,60 dhe 69 të LPP-së sepse të gjitha dokumentet/dëshmitë e cituara më lartë janë dorëzuar konform kërkesave të dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim. Në dosjen e tenderit tek kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 17 (shtatëmbëdhjetë) punëtorë të mjaftueshëm 5 (pesë) drejtues të makinave të poshtë shënuara, 4(katër) mjeshtër dhe 8(tetë) punëtor fizikë si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e projektit a) një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë - (konstruktor ose hidro-inxhinjer), b) një gjeodet, e dëshmuar me listën e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore, CV-a, diploma, kontrata e punës me ofertuesin (origjinal në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë). Eksperti shqyrtues sqaron se grupi i OE N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk gjatë dorëzimit të tenderit ka dorëzuar një kontratë për punësim në mes të “Marash Shped” Shpk dhe z. Bekim Bytyqi-Ing i dip i ndërtimtarisë. Në nenin 3 të kësaj

kontrate specifikohet që kontrata lidhet për projektin “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve me nr. prok:632-20-1237-5-2-1. Gjithashtu, është dorëzuar edhe Diploma e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në emër të Bekim Bytyqi i diplomuar në këtë fakultet me datë 04 Korrik 2008-Drejtimi Konstruktiv si dhe një CV në emër të Bekim Bytyqit më të gjitha të dhënat e nevojshme. Grupi i OE N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk gjithashtu ka dorëzuar edhe një kontratë për punësim në mes të “Marash Shped” Shpk dhe z. Agon Blakaj -gjeodet. Në nenin 3 të kësaj kontrate specifikohet që kontrata lidhet për projektin “Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve me nr. prok:632-20-1237-5-2-1. Gjithashtu, është dorëzuar edhe Diploma e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në emër të Agon Blakaj i diplomuar në këtë fakultet me datë 22 Korrik 2015-Drejtimi Gjeodet si dhe një CV në emër të Agon Blakaj më të gjitha të dhënat e nevojshme.

Eksperti shqyrtues konsideron se dokumentet/dëshmitë e dorëzuara nga OE ankues janë konform kriterëve të kërkuara në dosje të tenderit dhe pretendimet e OE ankues janë të qëndrueshme. AK edhe si në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar (B42) po ashtu edhe në përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim nuk ka ofruar asnjë sqarim se përse këto dokumente/dëshmi nuk janë konform kërkesave të dosjes së tenderit. Konsideroj që pretendimi ankimor është i bazuar

Përgjigje në Pretendimin 2, Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues, se AK ka rekomanduar për kontratë ofertën e N.N.Sh “Korben” edhe pse kjo ofertë nuk i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit tek kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional, respektivisht disa pajisje nuk janë konform specifikave të kërkuara në dosje të tenderit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-pajisje teknike për realizimin e kontratës siç janë a.) 1 eskavator (makineri me strukturë rrotulluese) me peshë totale mbi 10t, b.) 2 kamionë me konstruksion ndërtim kiper me peshë totale mbi 10t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit) c.) 2 cilindra apo rula ngjeshës me peshë totale mbi 7t d.)1 bager deri në 10 t.

OE i rekomanduar për kontratë N.N.Sh “Korben” ka dorëzuar një listë të pajisjeve që i ka në pronësi të tij së bashku me dëshmitë e përcjellëse (certifikatën e regjistrimit të automjeteve dhe dokumentin unik doganor). Sipas këtyre dokumenteve është ofruar vetëm një kamion me peshë mbi 10 ton ndërsa në dosje të tenderit janë kërkuar dy kamion me peshë mbi 10 ton. Dëshmitë për cilindrata ngjeshës në këtë listë nuk janë me peshë mbi 7 ton si dhe mungon dëshmia për pajisjen bager deri në 10 ton. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar edhe një kontratë mbi qiranë e mjeteve motorike me “Aim Shpk” Klinë ku janë të specifikuara të gjitha pajisjet të marr me qira. Për këto pajisje nuk janë ofruar certifikatat e regjistrimit të pajisjeve apo dokumentet unik doganor.

Disa dokumente unik doganor të dorëzuara së bashku me kontratën mbi qiranë e mjeteve motorike nuk dëshmojnë se janë të dhënësit të pajisjeve me qira “Aim Shpk” Klinë, por në dëshmitë e prezantuara këto pajisje janë në pronësi të N.N.T “Mirusha Transport” Shpk. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Mendimi i ekspertit profesional: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovohet si e bazuar**, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në **rivlerësim**.

Operatori ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 14.07.2020 ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit profesional.

Autoriteti Kontraktues përmes shkresës zyrtare me datën 13.07.2020 është njoftuar nga OSHP lidhur me mendimin e ekspertit, mirëpo i njëjti nuk ka kthyer përgjigje.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 27.07.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e grupit të OE N.T.Sh “Marash-Shped” Shpk & “Company Zuka Commerce” Shpk, se AK gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk kemi prezantuar CV-të dhe kontratat e punës për inxhinierin e ndërtimtarisë-drejtimi konstruktiv dhe për gjeodetin, që sipas OE ankues AK ka bërë shkelje të nenit 6,7,56,59,60 dhe 69 të LPP-së sepse të gjitha dokumentet/dëshmitë e cituara më lartë janë dorëzuar konform kërkesave të dosjes së tenderit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se në dosjen e tenderit tek kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 17 (shtatëmbëdhjetë) punëtorë të mjaftueshëm, 5 (pesë) drejtues të makinave të poshtë shënuara, 4(katër) mjeshër dhe 8(tetë) punëtor fizikë, si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e projektit a) një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë - (konstruktor ose hidro-inxhinjer), b) një gjeodet, e dëshmuar me listën e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore, CV-a, diploma, kontrata e punës me ofertuesin (origjinal në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë). Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se grupi

i OE N.T.Sh "Marash-Shped" Shpk & "Company Zuka Commerce" Shpk gjatë dorëzimit të tenderit ka dorëzuar një kontratë për punësim në mes të "Marash Shped" Shpk dhe z. Bekim Bytyqi-Ing i dip i ndërtimtarisë. Në nenin 3 të kësaj kontrate specifikohet që kontrata lidhet për projektin "Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve me nr. prok:632-20-1237-5-2-1. Gjithashtu, është dorëzuar edhe Diploma e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në emër të Bekim Bytyqi i diplomuar në këtë fakultet me datë 04 Korrik 2008-Drejtimi Konstruktiv si dhe një CV në emër të Bekim Bytyqit më të gjitha të dhënat e nevojshme. Gjithashtu, ka dorëzuar edhe një kontratë për punësim në mes të "Marash Shped" Shpk dhe z. Agon Blakaj -gjeodet. Në nenin 3 të kësaj kontrate specifikohet që kontrata lidhet për projektin "Sanimi dhe Ndërtimi i parqeve me nr. prok:632-20-1237-5-2-1. Po ashtu, është dorëzuar edhe Diploma e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës në emër të Agon Blakaj i diplomuar në këtë fakultet me datë 22 Korrik 2015-Drejtimi Gjeodet si dhe një CV në emër të Agon Blakaj më të gjitha të dhënat e nevojshme. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional konsideron se dokumentet/dëshmitë e dorëzuara nga OE ankues janë konform kriterëve të kërkuara në dosje të tenderit dhe pretendimet e OE ankues janë të bazuara. AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar (B42) dhe po ashtu edhe në përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim nuk ka ofruar asnjë sqarim se përse këto dokumente/dëshmi nuk janë konform kërkesave të dosjes së tenderit. Andaj, pretendim ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues OE N.T.Sh "Marash-Shped" Shpk & "Company Zuka Commerce" Shpk, se AK ka rekomanduar për kontratë ofertën e N.N.Sh "Korben" edhe pse kjo ofertë nuk i përmbush kërkesat e dosjes së tenderit tek kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional, respektivisht disa pajisje nuk janë konform specifikave të kërkuara në dosje të tenderit, Paneli Shqyrtues konform eksperti profesional sqaron se në dosje të tenderit është kërkuar që operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-pajisje teknike për realizimin e kontratës siç janë a.) 1 eskavator (makineri me strukturë rrotulluese) me peshë totale mbi 10t, b.) 2 kamionë me konstruksion ndërtim kiper me peshë totale mbi 10t (kamionët duhet të kenë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid të regjistrimit) c.) 2 cilindra apo rula ngjeshës me peshë totale mbi 7t d.) 1 bager deri në 10 t.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se OE i rekomanduar për kontratë N.N.Sh "Korben" ka dorëzuar një listë të pajisjeve që i ka në pronësi të tij së bashku me dëshmitë e përcjellëse (certifikatën e regjistrimit të automjeteve dhe dokumentin unik doganor). Sipas këtyre dokumenteve është ofruar vetëm një kamion me peshë mbi 10 ton ndërsa në dosje të tenderit janë kërkuar dy kamion me peshë mbi 10 ton. Dëshmitë për cilindrata ngjeshës në këtë listë nuk janë me peshë mbi 7 ton si dhe mungon dëshmia për pajisjen bager deri në 10 ton. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar edhe një kontratë mbi qiranë e mjeteve motorike me "Aim Shpk" Klinë ku janë të specifikuara të gjitha pajisjet të marr me qira. Për këto pajisje nuk janë ofruar certifikatat e regjistrimit të pajisjeve apo dokumentet unik doganor. Disa dokumente unik doganor të dorëzuara së bashku me kontratën mbi qiranë e mjeteve motorike nuk dëshmojnë se janë të dhënësit të pajisjeve me qira

“Aim Shpk” Klinë, por në dëshmitë e prezantuara këto pajisje janë në pronësi të N.N.T “Mirusha Transport” Shpk. Andaj, ky pretendim ankimor është i bazuar.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pasur në dispozicion dhe në sqarimet e ekspertit profesional të prokurimit, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues gjatë vlerësimit të tenderëve ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së, respektivisht kërkesave të përcaktuara në dosje të tenderit. Andaj, obligohet AK që gjatë rivlerësimit të ofertave të bëjë ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe nenit 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuh PACARIZI



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Kuvendi Komunal Gjakovë

1x1 OE “N.T.SH “MARASH-SHPED” SH.P.K.- Gjakovë & “COMPANY ZUKA COMERCE” SH.P.K. - Gjakovë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.